




Funded by  
the European Union



# KALAJA E BASHTOVËS



CH  
WB



Cultural  
Heritage without Borders

ALBANIA






# Kalaja e Bashtovës



Ky libërth është krijuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e CHwB Albania dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe /ose UNOPS-it.



Kalatë janë vende të rrethuara me mure të larta. Ato janë ndërtuar në kohëra të hershme që njerëzit të ndihen të sigurtë dhe të mbrojtur nga rreziku i luftërave.



Kalatë ndërtohen në vende të larta, të thepisura, që të jenë të vështira për t'u sulmuar. Por, a e dini që ka edhe kala të ndërtuara në fushë?

Në fushë është më e lehtë të ndërtohet. Prandaj dhe forma e kalasë së Bashtovës është kaq e rregullt.



Kalatë njihen shpesh me emrin e qytetit apo të vendit ku janë ndërtuar. Plotëso emrin e çdo kalaje me emrin e qytetit.

Berat  
Gjirokastër  
Porto Palermo  
Shkodër



Kalaja e .....



Kalaja e .....




Kalaja e .....




Kalaja e .....


Kalatë kanë qenë simbol i qëndresës. Në muret e fortifikuara të tyre kishte kulla, të ndërtuara për të vrojtuar sulmuesit dhe betejat. Këto ndërtesa të ngushta e të larta ishin në formë katërkëndëshe dhe rrethore – rrethoret ishin më të forta.



Në këtë kala ka dhe shumë harqe. Vizato dhe ti një hark ose formën gjeometrike që të pëlqen më shumë te kalaja.



E gjendur pranë detit Adriatik dhe grykëderdhjes së lumit Shkumbin, pranë të cilit kalonte rruga e vjetër Egnatia, Kalaja e Bashtovës ndodhej dikur në një pozicion të shkëlqyer gjeografik.





Lumi i vinte qark kalasë dhe ofronte një lidhje më të mirë e më të shpejtë me detin. Banorët e saj e shfrytëzonin këtë përparësi për të tregtuar me vendet fqinje në kohë paqeje.



Kalaja e Bashtovës ka qenë për një kohë të gjatë nën zotërimin e familjes fisnike shqiptare Matranga.

Në mesjetë, ka patur disa familje të njohura fisnike shqiptare. Gjej cilës familje i përket secila emblemë:



- Balshaj
- Topiaj
- Kastrioti
- Muzakaj




Familja Matranga




Familjet fisnike mesjetare kishin emblemat e tyre. Ato shpesh ishin simbole të përbëra nga këto elemente:

### MBUROJA




### FUSHA DHE NDARJA




### SIMBOLI




Cilat elemente do të zgjidhje për të bërë një embleme të familjes sate?  
Vizatoje atë duke zgjedhur mburojën, fushën, ndarjen dhe simbolin që pëlqen.





Bukur, tani që keni emblemën e familjes,  
për t'u bërë fisnikë të vërtetë  
mesjetarë, ju duhet dhe një kala!

Vizato ku dhe si do të dëshiroje ta ndërtoje kalanë tënde.



Nga këto anë kanë kaluar disa nga luftëtarët më të fuqishëm të kohëve të tyre.  
Në cilët shekuj kanë jetuar ata? Plotëso kutizën.

.....

Ky është një luftëtar romak.  
Ai ka kaluar dhe ka luftuar  
këtu kur ky vend quhej Iliri.

.....

Ky është një luftëtar norman,  
pasardhës i vikingëve. Ai ka  
kaluar këtu njëmijë vjet më  
parë.

.....

Ky është një luftëtar nga  
Venediku, superfuqia detare  
e Mesdheut. Ai ka shoqëruar  
anijet që kanë bërë tregti me  
banorët e kalasë.

.....

Ky është një jeniçer i Perandorisë Osmane.  
Jeniçerët ishin më të besuarit e sulltanëve  
dhe ushtarët e parë profesionistë në Europë.

.....

Unë jam arbër, kam qenë dhe do  
të jem gjithmonë këtu. Njihem për  
trimëri dhe zgjuarsis, ama mikpritja  
është ajo që kam në zemër.

Pranë Bashtovës ka ndodhur dhe një nga luftërat më të famshme të antikitetit, ajo mes Pompeut dhe Cezarit. Edhe pse Pompeu kishte një ushtri dyfish më të madhe, ishte Cezari ai që doli fitimtar në fund të luftës.




**Pompeu**



**Cezari**



Muret e kalasë janë rindërtuar disa herë, për t'iu përshtatur armëve të reja.  
A i njihni pjesët përbërëse të tyre?



Kalatë janë ndërtuar duke përdorur materiale dhe mënyra që nuk e dëmtojnë natyrën. Restaurimi i tyre në kohët e sotme bëhet me të njëjtat teknika:




gur gëlqeror



tulla




druri



llaçi

Ngjyros sipas materialeve këtë pjesë të kalasë.






Muret e kalasë janë të forta, por ato kanë nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme. Ndhimo në restaurimin e tyre.



Një pjesë e murit është shembur. Rindërto atë duke vendosur gurët e rrëzuar.

Kontrollo me kujdes bedenat. Sigurohu që nuk ka krisje dhe rindërto ato që janë dëmtuar.

Kontrollo me kujdes muret e kalasë. Ato mund të dëmtohen nga erozioni (gërryerja).



Unë punoj me artefaktet e gjetura. Përmes tyre studioj sesi kanë jetuar njerëzit në kala.

Kujdesem që kalaja të jetojë sa më gjatë, duke përdorur materiale tradicionale për t'ia ruajtur mjeshtërinë e ndërtimit.

Unë punoj gurin dhe rindërtoj pjesët e dëmtuara të kalasë. Këtë zanat e kam të trashëguar nga të parët e mi.

Kalaja ka gjithnjë e më shumë vizitorë. Unë u rrëfej atyre historinë e veçoritë e saj.



Arkeologu

Arkitektja - Restauratore

Mjeshtri

Guida turistike

Arkeologët po punojnë në kala.  
Çfarë po bëjnë ata?

1. Gërmojnë ngadalë dhe me kujdes. Ata shohin ngjyrën dhe fortësinë e dheut për të dalluar shtresat.

2. Gjejnë artefakte dhe me kujdes i vendosin në një qese me emër dhe numër të veçantë.

3. Pastrojnë dhe sistemojnë me kujdes vendin pas gjetjeve.

4. Pastrojnë, fotografojnë dhe regjistrojnë artefaktet.

mistria

dorezat

lopata dhe kazma

furça



lupa

metri

aparati fotografik

Gërmo bashkë me arkeologët në kalanë e Bashtovës.  
Qarko artefaktet që mendon se mund të gjesh aty.

Të lumtë! Gjete disa artefakte gjatë gërmimit. Tani ndihmo me ruajtjen e tyre:  
sigurohu që plotësimet e tua të dallohen nga pjesët origjinale.




Sot në kalanë e Bashtovës zhvillohen aktivitete të ndryshme, si panaire, koncerte, konkurse bukurie, vizita turistike e plot të tjera.



Po ti, çfarë aktivitetestesh do të doje të shihje në Bashtovë? Vizatoji ato.




# Fjalorth




- arkeologji** studimi i jetës së njerëzve në të kaluarën, përmes objekteve që ata lanë pas.
- artefakt** objekte me vlerë historike, të bëra nga njerëzit dhe të gjetura gjatë gërmimeve arkeologjike.
- beden** pjesë e ngritur si dhëmb mbi murin rrethues të një kalaje, prapa së cilës mbroheshin luftëtarët vendas.
- emblemë** stemë me simbolet përkatëse të një familjeje fisnike mesjetare.
- erozion** gërryerje e mureve të kalasë nga era ose uji.
- frëngji** hapësirë e vogël në muret e kalasë, nga ku ushtarët mund të vëzhgonin e mbroheshin në rast nevoje.

- gërmim arkeologjik** gërmimi me qëllim zbulimin e gjurmëve e objekteve të vjetra që ndodhen nën tokë.
- hark (qemer)** pjesë e sipërme e një dritareje, dere, muri etj., e ndërtuar si gjysmërreth.
- kala** vend i rrethuar me mure për t'u mbrojtur nga armiqët për një kohë të gjatë.
- kullë** ndërtesë e vogël dhe e ngushtë, në pikat kyçe të kalave, prej së cilës mund të vrojtohet larg.
- portë hyrëse** portë kryesore nga e cila njerëzit mund të hynin në kala.
- restaurim** ndërhyrje me qëllim plotësimin dhe ruajtjen e jetëgjatësisë së objekteve e monumenteve që janë pjesë e trashëgimisë sonë kulturore.





Emri: \_\_\_\_\_



Çfarë të bëri më shumë përshtypje nga ky libërth?

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_


\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_





Na trego mbresat e tua:





## Sitet e tjera EU4Culture në Shqipëri



Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë



Teatri Kombëtar i Kukullave, Tiranë



Minitria e Kulturës, Tiranë



Ndërtesa e Institutit të Ish-të Përndjekurve Politikë, Tiranë



Muzeu Arkeologjik, Durrës



Muzeu Etnografik, Durrës



Hamami, Durrës



Torra Veneciane, Durrës



Kisha e Shën Ndojit, Rodon



Kalaja e Ishmit



Muzeu Etnografik, Krujë



Ura e Kurçajt, Krujë



Kisha e Manastirit, Rubik



Rrënojat e Kishës së Shën Mërisë, Mamurras



Ish-Arqipeshkvia, Laç



Kalaja e Lezhës



Muzeu Etnografik, Kavajë



Kalaja e Bashtovës, Rrogozhinë

Në të njëjtin gjerdan  
libërthash do të gjeni



GJERDANI I LIBËRTHAVE, PJESË E SË CILIT ËSHTË DHE KY BOTIM,  
ËSHTË PJESË E PROJEKTIT  
**“PLATFORMAT E FUQIZIMIT DHE TË MËSIMIT PËRMES TRASHËGIMISË”**  
TË FINANCUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN NË KUADËR TË PROGRAMIT  
EU4CULTURE, TË ZBATUAR NGA UNOPS-I NË KOORDINIM ME  
MINISTRINË E KULTURËS.

“Ky projekt, i cili u zbatua nga CHwB Albania, mundësoi realizimin e katër libërthave për fëmijë mbi Muzeun Etnografik të Kavajës, Muzeun Etnografik të Krujës, Urën e Kurçajt (Krujë) dhe Kalanë e Bashtovës (Rrogozhinë). Këto libërtha u bashkëkrijuan me përfaqësues nga institucionet publike vendore e qendrore, profesionistë e qytetarë aktivë në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore nga qytetet përkatëse. Qëllimi i këtyre libërthave është forcimi i njohurive të fëmijëve të moshave 6 - 11 vjeç mbi disa prej vlerave më të veçanta të trashëgimisë sonë kulturore, si dhe të shërbyerit si mbështetje për aktivitete praktike pranë siteve të përmendura e jo vetëm, që kanë trashëgiminë kulturore në fokus.”

### **Kalaja e Bashtovës**

**Botues:** Cultural Heritage without Borders Albania (CHwB Albania)

**Koncepti:** Mirian Bllaci, Arnold Kapinova, Lidia Saliko

**Konsulent për materialin historik:** Gjerak Karaiskaj

**Konsulente për tekstin dhe redaktimin:** Luljeta Dano, Rudina Çupi

**Ilustrimet:** Lidia Saliko

**Përpunimi grafik, faqosja:** Lidia Saliko

**Drejtues projekti:** Mirian Bllaci

**Botimi i parë:** 2023

© CHwB Albania

ISBN 978-9928-801-02-9

Ky libërth është krijuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e CHwB Albania dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe/ose UNOPS-it.

### **CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Kalaja e Bashtovës / koncept. Mirian Bllaci,

Arnold Kapinova, Lidia Saliko :

red. e konsult. Luljeta Dano , Rudina Çupi. - Tiranë :

Cultural Heritage without Borders Albania, 2023

56 f. : me il. ;25x25cm.

ISBN 978-9928-801-02-9

1.Antikitete 2.Kështjella 3.Botime për fëmijë 4.Kavajë 5.Shqipëri

087.5 ;904(496.5)

